

POLITIKË

31. marsh 2023. • 17:43 / Burim: Kosovo Online

Petriç: Kurti "zbut" qëndrimin rreth BKS, zgjedhjet pa sërëbët nuk kanë legjitimitet



Burim: N1 Info

Marrëveshja në Ohër solli përshpejtimin e procesit të negociatave me qëllim arritjen e normalizimit të marrëdhënieve mes Sërbisë dhe Kosovës, vlerëson ish i dërguari i BE për Kosovën, Wolfgang Petriç dhe pret që të hënën, në takimin e negociatorëve kryesorë, të diskutohet rreth implementimit të marrëveshjes.

"Më duket se vijimi i dialogut të vazhdueshëm i të dy palëve, e veçanërisht tani Prishtina, ose Albin Kurti, po tregojnë zhvendosje prej qëndrimeve të tyre, mbi të gjitha për themelimin e Bashkësisë së Komunave Sërbe për të cilën është dakordësuar kohë më parë" ka thënë Petriç për Kosovo Onlajn.

Bëhet e ditur se tani pala prishtinase është fleksibël, çka vlerësohet si mjaft pozitive.

Petriç tregon se dhe procesi i dialogut tashmë sërish është formësuar nga ana e Bashkimit Europian nën mbështetjen e SHBA.

"Qëllimi është se mbi gjithçka, të sigurohet implementimi i marrëveshjes. Tani vëmendja do të jetë tek implementimi çka është i saktësuar. Nevojitet të perparohet hap pas hapi drejt normalizimit të marrëdhënieve" ka sqaruar Petriç.

Në lidhje me takimet e planifikuara të negociatorëve kryesorë të hënën, ai tha se e rëndësishme është që të "mos humbet momenti aktual"

"E rëndësishme është të bisedohet, pasi negociatat vërtet çojnë në arritjen e diçkaje të mirë dhe për komunitetin sërb" ka shtuar Petriç.

Sipas fjalëve të tij, takimet e shpeshta, janë reflektim i padurimit të Brukselit e Uashingtonit, të cilët dëshirojnë përparim të shpejtë e me këtë rast edhe takime të shpeshta.

Në këtë kuptim ai kujton se edhe BE ka theksuar se nëse do të ketë përparim në implementimin e marrëveshjes, mund të ketë përparim edhe në procesin e anëtarësimit.

Kur është fjala për zgjedhjet e shpallura në veri të Kosovës, Petriç tha se do të ketë probleme nëse ato mbahen pa pjesëmarrjen e sërëbëve.

"Nëse sërëbët nuk marrin pjesë, zgjedhjet nuk do të kenë kuptim. Pala sërbe duhet të mendojë se cilat janë avantazhet dhe cilat janë disavantazhet nëse nuk marrin pjesë dhe anasjelltas. Komuniteti sërb në Kosovë, ka dëshmuar se pjesëmarrja, pra hyrja në institucionet e Kosovës, ka ofruar diçka. Por për pjesëmarrjen në zgjedhje duhet të vendos lidhshipi i sërëbëve në veri" ka speguar ai.

Petriç theksoi se sigurisht organet e zgjedhura, do të kishin vetëm legjitimitet të cunguar, nëse në përgjithësi do t'a kishin, pra nëse zgjedhjet do të kalonin pa pjesëmarrjen e sërëbëve.

"Jam i mendimit se duhet të ndiqet shembulli i Millorad Pupovacit i cili udhëhoqi një politikë inteligjente për komunitetin e vet në Kroaci ku mori pjesë në institucione. Megjithatë, kjo sigurisht varet nga gatishmëria e qeverisë për kompromis dhe në këtë rast të Prishtinës" ka thënë Petriç.

Ky i fundit shtoi se Kurti, duke pranuar themelimin e Bashkësisë së Komunave Sërbe, tregoi njëfarë "gatishmërie për të hequr dorë nga mosgatishmëria për kompromis".

Kur bëhet fjalë për BKS, Petriç është i bindur se me pjesëmarrjen në institucione, sërëbët do të mund t'i përmirësonin ato "nga brenda", sepse nga jashtë kjo është e pamundur.

MARRËVESHJA E OHRIT KOSOVA SËRBI DIALOGU ZGJEDHJET

31. marsh 2023. • 17:43 / Burim: Kosovo Online

VERIU I KOSOVËS

0 KOMENTET



TË GJITHA KOMENTET

POVEZANE VESTI



POLITIKË

Stano: Institucionet e BE-së po fillojnë me Beogradin dhe Prishtinën për të zbatuar marrëveshjen nga Ohri
Institucionet e Bashkimit Evropian, me mbështetjen e liderëve të BE-
28. marsh 2023.



POLITIKË

24. marsh 2023.

Makron: Përshëndes marrëveshjen e Ohrit, thelbësore që palët treguan përgjegjësi




POLITIKË

23. marsh 2023.


Hill: BKS do të jetë në kuadër të marrëveshjes së Brukselit, dizenjimi i saktë

7°C 3.4.2023. MitoVica

E fundit



Vuçiq: Besoj në miqësitë e ardhshme midis sërëbëve dhe shqiptarëve
17:38




Simiq: Prishtina po përdor forcën kundër sërëbëve në Kosovë e Metohi
16:28



Thyerja e mitit për UÇK-në: Fillimi i gjyqit të Hashim Thaçit dhe komandantëve të tjerë
16:18



Rakiq: Lëvizjet e fundit të Prishtinës po shkaktojnë revoltë te sërëbët në Kosovë e Metohi
15:13



Daçiq: Bashkësia ndërkombëtare duhet urgjentisht ta ndalë Kurtin, një krizë e re është në horizont
14:54


SVE NAJNOVIJE >




Radio KFOR 96.6 Srpski
@RadioKfor966 - Radio station



Izdvojamo



Pogled kroz haške rešetke: Kakvo Kosovo je ostavio Hašim Tači, a kakvo je ono danas?
1



Gjyqësori në "arrest shtëpie": A ka shance për drejtësi në Kosovë?
2




Çfarë ndryshoi në Ohër: A u zgjidhën të gjitha dyshimet për formimin e BKS?
3



Greqia e Kosova-lidhje për një natë
4




FEJTON: Kosova - Kujtimet e ambasadorit të fundit amerikan në Jugosllavi (I)
5



Srpsko-albanske zablude o Kosovu: Ima li nade za razumevanje?
6

SVE IZDOJENE VESTI >


Më popullore



Srpska lista: Nasilnici u uniformi raspoređeni na severu maltretirali ženu sa detetom u naručju
1



Rakić: Najnoviji potezi Prištine izazivaju revolt kod Srba na KiM
2



Policija uhapsila osumnjičenog za paljenje automobila na severu Kosova
3

SVE MË POPULLOR VESTI >

